# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-436774**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Goditen 3 raste të prostitucionit në Tiranë, në pranga 4 persona |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/goditen-3-raste-te-it-ne-tirane-ne-pranga-4-persona-i585395` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 12:35:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 13:10:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1ce0970b5bf04d2d99e0bf3035f913483de780773169ac874450ce81ba72aec8` |
| TEKSTI | `8fee6832acb1faeea3ed5a9b27c654058848f9b2b5dee50b11d905ebfa7d04b3` |
| PAMJA | `bdb8237acc54de6dc079ec115aef713be9e53849495bbf7d9f65d03ea0a4fa24` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `eb4fd7a5f4c2f49ca9ceb94dc51c0370886388049c0604712be428365107ea56` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `903741db4cfe797987b28699db3fa9d772614b5785f66c1ee193e066d4535c4a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/eb4fd7a5f4c2f49ca9ceb94dc51c0370886388049c0604712be428365107ea56`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Goditen 3 raste të prostitucionit në Tiranë, në pranga 4 persona

11 Shtator 2026, 15:10Kronika TEMA

![Goditen 3 raste të prostitucionit në Tiranë, në pranga 4]

Tre raste të prostitucionit të cilat reklamoheshin edhe në rrjetet sociale është goditur në Tiranë. Policia bën me dije se janë vënë në pranga një shqiptar dhe 3 gra të huaja.

Ata dyshohet se kishin përshtatur apartamente të marra me qira ditore, për ushtrim të prostitucionit, në rrugët "Xhoxhi Martini", "Milan Shuflaj" dhe "Him Kolli". Gjithashtu u procedua penalisht një person i cili ishte përfitues nga kjo veprimtari e kundërligjshme.

"Tiranë/Finalizohet faza e dytë e operacionit të koduar "Last post". Goditen 3 raste të tjera të reklamimit në rrjete sociale, të prostitucionit të ushtruar në apartamente me qira ditore, në kryeqytet.

Arrestohen 3 shtetase vietnameze dhe braziliane, për ushtrim të prostitucionit. Në pranga dhe 1 shtetas shqiptar që shfrytëzonte për këtë veprimtari, njërën prej shtetaseve vietnameze të arrestuara.

Sekuestrohen 4 celularë që dyshohet se përdoreshin për reklamimin e këtij veprimtarie, në rrjete sociale.

Në vijim të verifikimeve, punës operative dhe asaj hetimore, kryer në terren dhe në hapësirën digjitale, me objektiv konstatimin dhe goditjen e rasteve të reklamimit në rrjete sociale, të prostitucionit të ushtruar në apartamente me qira ditore, në lagje të ndryshme të kryeqytetit, specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqeve finalizuan fazën e dytë të operacionit të koduar "Last post".

Gjatë kësaj faze u arrestuan shtetasit: -I. L., 25 vjeçe, shtetase braziliane, dhe U. L., 42 vjeçe, shtetase vietnameze, pasi dyshohet se kishin përshtatur apartamente të marra me qira ditore, për ushtrim të prostitucionit, në rrugët "Xhoxhi Martini" dhe "Milan Shuflaj";

-E. H., 35 vjeç dhe Th. H., 37 vjeçe, shtetase vietnameze, pasi dyshohet se 35-vjeçari shfrytëzonte 37-vjeçaren, për ushtrim të prostitucionit në një apartament të marrë me qira ditore, në rrugën "Him Kolli".

Më tej, u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për një shtetas, përfitues nga kjo veprimtari e kundërligjshme. Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme", njofton policia.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Gara për kreun e Gjykatës së Lartë: Gjyqtari Ilir Panda dorëzon kandidaturën]

13:30 Kronika / 1 koment

["Pse më sheh" - Vrasja e 24-vjeçarit në Shkodër, gjykata lë në burg Andri Vulajn!]

13:20 Kronika / 2 komente

[Shiste mallra të kontrabanduara - Durrës, arrestohet pronari i dyqanit]

13:00 Kronika

[Ngërçi me pagat në drejtësi, gjykata urdhëron Thesarin të procesojë listëpagesat e GJKKO-së]

12:55 Kronika / 15 komente

[Dyshimet për rrëmbim dhe tetë vite pa përgjigje, Elvis Troqe shpallet zyrtarisht i zhdukur]

12:50 Kronika

[Po trafikonte 11 klandestinë nga Pakistani dhe Bangladeshi drejt vendeve të BE, arrestohet 27-vjeçarit në Korçë]

11:50 Kronika

[Luan Baçi në SPAK, deputeti demokrat paraqitet së bashku me avokatin]

11:09 Kronika / 4 komente

[Merr drejtimin e Ministrisë së Brendshme, Ervin Demo: Përgjegjësi e madhe, do të çojmë përpara prioritetet e qeverisë]

11:00 Kronika / 3 komente

[PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm?]

10:40 Kronika / 44 komente

["Kallëzimi në SPAK është idiot", Manjani: Ligji e ndalon, por gjyqtarët dhe prokurorët po bëjnë grevë…]

23:15 Kronika / 13 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**["Berisha gënjeu demokratët" - Bejko: Nuk ka më të drejtën...]**

09:45 Politika / 21 komente

**Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...**

15:45 Politika / 29 komente

**EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej "aferën e armëve" m...**

15:30 Dossier / 12 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 51 komente

**'Kallëzim se po zbatoj ligjin', ministri Malaj publikon p...**

19:05 Politika / 77 komente

## Blog Tema

**Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve**

13:50 Blog / 8 komente

**Ministrja që Rama po kërkon**

12:40 Blog / 12 komente

**Demokracia, jo më si vlerë lirie**

12:30 Blog / 4 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.